



Pranuar / Dorezuar Priljezeno / Predato Received / Delivered	21.02.2022	2	viti god year
Organ / Shista Organ / Jedinstvo Org / Unit	SIKPM/SHIK	902/2022	116
Hi Prof Hi Prof Prof. No.		Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 27/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.27/2020 të datës 14.01.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë Komuna e Prizrenit, kundër

Vendimit KA.nr.23/2021 të datës 10.12.2021, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike-administrative "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.27/2022 e datës 14.01.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi, Vendimi me numër KA.nr.23/2021 i datës 10.12.2021, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 14.01.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 150/22 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.23/2021 të datës 10.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullores Nr.02/201 për Procedurat e Rekrutimit dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga Komisioni Përzgjedhës, si dhe shkeljet lidhur me mos informimin e kandidateve lidhur rezultatet e testit me shkrim dhe njoftimin përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.01.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje referuar SKPK), ndërsa më datë 28.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoll 389/22 së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova:* Ankesën A.nr.27/2022 të datës 14.01.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference KPK/SKPK/ZKPSH/ZMNV/POZ-014 të shpallur me datë 07.10.2021; Njoftimin e datës 03.11.2021 për për zgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshme për pozitën e punës Mbikëqyrës i Zyrës Rajonale/Zyra për Mbrojtën dhe Ndihmën e Viktimave në Prizren; Vendimin me Nr.23/2021 të datës 10.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së; Ankesën e datës 23.11.2021 të ushtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKP-së; Përgjigjen në ankesë të SKP-së me numër protokoll 389/2021 të datës 28.01.2021, kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshillit me numër protokoll 237/2022 të datës 19.01.2022, Vendimin me numër protokoll 483/2021 të datës 31.03.2021 të Këshillit Prokuroria të Kosovës, Vendimin me numër protokoll DPSKPK 335/2021 të datës 19.10.2021 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil për pozitën Mbikëqyrës i Zyrës Rajonale/Zyra për Mbrojtën dhe Ndihmën e Viktimave në Prizren, Njoftimin e datës 21.10.2021 lidhur me njoftimin e kandidateve për përfshirje në listën e ngushtë, Regjistrimin e Aplikacioneve të Pranuar i datës 20.10.2021, Formularin e vlerësimit Individual të kandidateve, Përmbledhjen e Vlerësimeve individualë të testit me shkrim i datës 29.10.2021, Formularin e Vlerësimit të kandidateve në Intervistën me gojë nga Kryesuesi i Komisionit, Formularin e Vlerësimit të kandidateve në Intervistën me gojë nga anëtari i dytë i Komisionit përzgjedhës i datës 01.11.2021 Formularin e Vlerësimit të kandidateve në Intervistën me gojë nga anëtari i tretë i Komisionit Përzgjedhës Formularin e Vlerësimit të kandidateve në Intervistën me gojë nga anëtari i katërt i Komisionit Përzgjedhës Formularin e Vlerësimit të kandidateve në Intervistën me gojë nga anëtari i pestë i Komisionit Përzgjedhës deklaratën në gjuhën serbe për mosekzistimin e konfliktit të interesit të datës 28.10.2021, testin me shkrim të datës 28.10.2021 i deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit të i datës 28.10.2021, tetsin me shkrim të datës 28.10.2021, Raportin Final të Rekomandimeve nga Komisioni Përzgjedhës i datës 02.11.2021, Aplikacionin Nr.999 i datës 13.10.2021 për dorëzimin e kërkesës për aplikim të Kërkesën për punësim të me shkresat e bashkangjitura: ID, Diplomë më numër 3208, e datës 26.03.2015; Formular i Vlerësimit të Përformancës së Punës për vitin 2020, Formular i Vlerësimit të Përformancës së Punës për vitin 2019, Ndryshim dhe plotësim i Aktit të Emërimit në gjuhën serbe DLJR/GDSTK/996/2021 i datës 01.10.2021 Certifikaë për ndjekje penale Pnr.11262/2021 e datës 08.10.2021, Vendimin me numër protokoll 1266/2013 lidhur me caktimin e Ushtrues e detyrës së Mbikëqyrëses se Zyrës Regjionale në Prizren, Akt Emërimi me numër protokoll ZBNJ/DP-354/2013 i datës 01.11.2013, Aplikacioni nr.1013 i datës 14.10.2021 për dorëzimi të kërkesës për aplikim të Kërkesën për punësim të e datës 14.10.2013 së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur: Diplomë më numër 1256 e datës 15.03.2006, Vërtetimin DBNJ/Nr.15/2021 i datës 11.10.2021, Vërtetim me numër protokoll 837 i datës 13.10.2021, Ndryshim dhe Plotësim i Akt emërimit

DBNJ/DPSKPK/982/2021 i datës 01.10.2021, Rekomandim, letër rekomandim e datës 12.10.2021, Formular i Vlerësimit të Përformancës së Punës për vitin 2020, Formular i Vlerësimit të Përformancës së Punës për vitin 2019, Certifikatë mbi trajnimet e ndjekura, Certifikatë e ndjekjes penale P.nr.11332/2021 të datës 11.10.2021, kopje e ID-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 07.10.2021 ka shpallur konkursin e brendshëm avancim në karrierë me numër reference KPK/SKPK/ZKPSH/ZMNV/POZ-01, për pozitën e punës Mbikëqyrës i Zyrës Rajonale/ Zyra për Mbrojtën dhe Ndihmën e Viktimave në Prizren. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 07.10.2021 deri me datë 14 tetor 2021, ndërsa interesim konkurrimi kanë shprehur gjithsej pesë(5) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesin Në listën e ngushtë të datës 21.10.2021 janë përfshirë vetëm katër (4) kandidatë: dhe testit me shkrim i mbajtur me 28.10.2021, i janë nënshtruar dhe kurse në intervistën më gojë të datës 01.11.2021 kanë marrë pjesë kandidatet dhe

Komisioni Përzgjedhës i themeluar me Vendimin me numër protokolli DPSKPK 335/2021, të datës 19.10.2021 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të SKP-së, në Raportin Final të datës 02.11.2021 ka vlerësuar kandidaten si kandidatja me e suksesshme dhe ka rekomanduar përzgjedhjen e saj në pozitën në fjalë. Konform Rekomandimit të Komisionit Përzgjedhës, Njësia e Burimeve Njerëzore të SKPK-së, me datë 03.11.2021 ka publikuar Njoftimin për Përzgjedhjen përfundimtare të si kandidatja me e suksesshëm për pozitën Mbikëqyrës i Zyrës Rajonale/ Zyra për Mbrojtën dhe Ndihmën e Viktimave në Prizren.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare, me datë 23.11.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me Nr.23/2021 të datës 10.12.2021, ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Njoftimin e datës 03.11.2021 për Përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën Mbikëqyrës i Zyrës Rajonale/Zyra për Mbrojtën dhe Ndihmën e Viktimave në Prizren, sipas konkursit të datës 07.10.2021.

Kundër vendimit të KZKA-së, ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullores Nr.02/201 për Procedurat e Rekrutimit dhe Rregullores nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga Komisioni Përzgjedhës, si dhe shkeljet lidhur me mos informimin e kandidateve lidhur rezultatet e testit me shkrim dhe njoftimin përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm. Tutje thekson se Komisioni Përzgjedhës ka bërë vlerësim të kundërligjshëm të intervistës me gojë dhe testit me shkrim duke ndarë me pak pikë se sa janë të parapara për përgjigjen dhe se kandidati i zgjedhur nuk ka përvojën e punës pas diplomimit dhe kohën e duhur për avancim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Aktgjykimin me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e



kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë ka gjetur së Gjykata Kushtetuese në pikën III të aktgjykimit ka konstatuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë.* Andaj, në kuptim të këtij aktgjykimi Kolegji vlerëson se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në raport me Këshillin Prokurorial zbatohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se në konkursin me numër reference KPK/SKPK/ZKPSH/ZMNV/POZ-01, të shpallur me datë 07.10.2021, si kriteret themelore të konkursit janë përcaktuar: *Diplomë e Fakultetit Juridik dhe tre (3) vite përvojë pune profesionale.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni Përzgjedhës ka bërë vlerësim të kundërligjshëm të testit me shkrim duke ndarë me pak pikë se sa janë të parapara për përgjigjen dhe se i njëjti bërë vlerësimi jo të drejtë të intervistës me gojë, Kolegji nga analizimi i testit me shkrim të ankuesit dhe bazuar në krahasimin e përgjigjeve me çelësin e testit, ka konstatuar së përmbajtja e testit me shkrim ka qenë në pajtim me nenin 36 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, dhe se Kolegji nuk ka hasur në ndonjë parregullsië përkitazi me vlerësimin e saktësisë së përgjigjeve dhe vlerësimin gjatë intervistës nga ana e Komisionit përzgjedhës, kështu që në këtë kuptim rrjedhë së është i pa bazuar pretendimi ankimor si me lartë.

Po ashtu, në kuptim të përmbushjes së kërkesave ligjore përkitazi me avancimin në shërbimin civil, Kolegji duke u bazuar në nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 9 dhe 10 të Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, ka konstatuar së kandidatja e zgjedhur për pozitën e punës së Mbikëqyrëses së Zyrës Rajonale/Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave në Prizren, ka plotësuar kërkesat për avancim gjegjësisht e ka kaluar kohën minimale për avancim pasi që sipas Akt Emërimit me numër protokollit ZBNJ/DP-534/2013 të datës 01.11.2013, e njëjta ka qenë e emëruar në pozitën "Mbrojtës i Viktimave" Zyra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Ndihmë Viktimave, ka plotësuar kualifikimet e kërkuar profesionale ashtu siç është përcaktuar me Konkursin e datës 07.10.2021, ka kaluar testin me shkrim dhe gojë, ndërsa sipas formularëve për vlerësim të performances së punës për vitin 2019 dhe 2020 është vlerësuar nga mbikëqyrësi i saj me notë të përgjithshme 3.8 (2019) dhe 3.9 (2020) pra "shumë mirë". E po në shkresat e lëndës nuk gjinden dëshmi për ndonjë masë disiplinore të shqiptuar ndaj kandidatës përzgjedhëse apo se ndaj të njëjtës është iniciuar ndonjë procedurë penale, andaj, bazuar në këtë konstatim Kolegji vlerëson se është i pa bazuar pretendimi ankimor se Komisioni Përzgjedhës ka bërë shkelje esenciale të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil dhe se kandidatja e përzgjedhur nuk ka kohën e duhur për avancim.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës respektivisht sipas Diplomës me Nr.3208 të datës 26.03.2015, ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur ka përfunduar studimet me datë 13.11.2014, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ndërsa sipas Akt Emërimit me nr.protokollit ZBNJ/DP-534/2013 të datës 01.11.2013, konstatohet se është e emëruar në pozitën Mbrojtëse e Viktimave në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në Prizren, dhe rrjedhimisht

Kolegji konstaton së e njëjta ka përvojën e kërkuar profesionale pas diplomimit e në veçanti në fushën respektive dedikuar mbrojtjes dhe ndihmës së viktimave, andaj, Kolegji konkludon se është i pabazuar pretendimi ankimor se kandidatja e përzgjedhur nuk ka përvojën e kërkuar pas diplomimit.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për mos njoftim me rezultatin e testit si dhe njoftimin përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshme, Kolegji nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se Njoftimi përfundimtar lidhur me kandidatin e suksesshme i datës 03.11.2021, është shpallur në webfaqen e sistemit prokurorial, ndërsa lidhur me njoftimin për rezultatin e testeve, Kolegji nga shkresat e lëndës nuk ka mundur të provoj se a është bërë apo jo një njoftim i tillë, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë është pjesërisht i bazuar .

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas listës përmbledhëse të vlerësimeve të Komisionit Përzgjedhës, kandidatja Semsije Sagdati është vlerësuar si kandidatja me e vlerësuar me gjithsej 73.3 pikë, andaj, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me të cilin është përcaktuar se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*.

Bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se procedura e konkurrimit për Mbikëqyrës i Zyrës Rajonale/Zyra për Mbrojtën dhe Ndihmën e Viktimave në Prizren, sipas konkursit të datës 07.10.2021, është zhvilluar në pajtim me nenin 11 Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.23/2021 të datës 10.12.2021, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar ne pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.*

Kështu që, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.Nr. 27/2022

Rushit KAJTAZI

*[Signature]*  
Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së